



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

MIRATOI
KRYETARI
Ilmi HOXHA



**RAPORT MBI VEPRIMTARINË E SEKTORIT TE AUDITIT TË
BRENDSHËM PËR PERIUDHËN JANAR -- DHJETOR 2022**

Klos, Shkurt 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Lënda: Raport mbi veprimtarinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm
për periudhën Janar – Dhjetor 2022

- I. **Përmbledhje Ekzekutive**
- II. **Baza Ligjore**
- III. **Organizimi**
 - Misioni i auditimit të brendshëm
 - Organizimi i Sektorit AB
- IV. **Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm**
 - Analiza e programeve të auditimit për vitin
 - Analiza e misioneve të auditimit.
 - Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre
 - Gjetjet kryesore sipas sistemeve
 - Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm
- V. **Rekomandimet**
 - Rekomandimet e propozuara
 - Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit
- VI. **Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë**
- VII. **Analiza e Kapaciteteve Audituese**
 - Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e Sektorit AB
 - Kapacitetet audituese
 - Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve
 - Analiza e kostos dhe shperndarja e burimeve
- VIII. **Konkluzione**
 - Konkluzione mbi problematikën e punës audituese
 - Prioritetet për vitin e ardhshëm

Raporti vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm paraqet informacion të përgjithshëm lidhur me realizimin e detyrave dhe nivelin e arritjes së objektivave të Sektorit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Klos për vitin 2022.

Auditimi i brendshëm është bazuar mbi njohjen e veprimtarisë dhe sistemeve të informacionit që kontribuojnë tek kontrolli i brendshëm dhe raportimi financiar. Sektori i Auditit të Brendshëm ka marrë në konsideratë risqet e përgjithshme me të cilët përballlet njësia, mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm ku vepron, kuadrin ligjor dhe rregullator, performancën e mëparshme financiare dhe sistemet e kontrollit të brendshëm të Bashkisë.

Objektiv i këtij raportimi është:

Komunikimi i rezultateve dhe angazhimeve të auditimit të brendshëm nëpërmjet analizës interpretimit dhe zbatimit të rekomandimeve për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

I. Përmbledhje ekzekutive

Raporti Vjetor mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm paraqet përgjegjshmëritë dhe strategjinë e programit të auditimit. Ai trajton menaxhimin e burimeve treguesit dhe matësit e performancës dhe shkallën e pajtueshmerisë me standartet profesionale.

Fokusimet e auditimit të brendshëm janë elementet kryesore për luftën ndaj abuzimeve ku audituesit e brendshëm kanë mundësinë më të mirë për parandalim, zbulim dhe ndjekjen e rasteve të tilla. Auditimi i brendshëm është pjesë integrale e menaxhimit të financave publike, dhe instrument për rritjen e performancës në sektorin publik.

Auditimi i brendshëm si veprimtari e pavarur mbështet menaxhimin për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë. . Sektori i Auditit të Brendshëm ushtron aktivitetin sipas përgjegjësi të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë detajuar në këtë raport, i cili përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e njësive të auditimit të brendshëm, ai përvijon procesin e planifikimit në bazë rrisht të përdorur gjatë veprimtarisë së auditimit të

brendshëm, mbi bazën e të cilit jepen opinionet, përshkruhet komunikimi i rekomandimeve dhe ndjekja e rezultateve.

Janë kryer (perfunduar) 5 misione auditimi kundrejt 6 misione të programuara, ose 83 % e planit vjetor. Në auditimet e kryera janë dhënë rekomandime të cilat janë të ndara sipas prioritetit. Ndjekja e rekomandimeve siguron informacion për vlefshmërinë e auditimeve, si dhe vlerëson cilësinë e punës audituese.

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit është një nga drejtimet ku është fokusuar menaxhimi. Në cdo rast të shkeljeve është përcaktuar përgjegjësia, ku edhe rekomandimet adresohen gjithnjë e më mirë, janë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

- Gjatë vitit 2022, auditimi i brendshëm ka treguar se kryerja e shërbimit të auditimit është jo vetëm një detyrim ligjor për tu permbushur por mbi të gjitha shton vlerën e subjekteve të audituar.
- Auditimi është mbështetur nga menaxhimi, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtij funksioni.
- Ngritja e cilësisë të punës audituese ka qenë faktor i cili ka ndikuar në forcimin e bindjes dhe sigurimit të mbështetjes nga menaxhimi.

II. Baza ligjore

- Ligji nr.114/2015 “Per auditimin e brendshëm në sektorin publik.”
- Ligji nr.139 dt.17.12.2015 “ Per vet qeverisjen vendore”.
- Ligji nr 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr 7961 datë 12.07 1995 “Kodi Punës”, i ndryshuar.
- Ligji nr 8399 datë 09.09.1998 “Për Buxhetin Lokal” i ndryshuar.
- Ligji nr 9228 dt.29.04.2004 ;“ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.
- Ligji nr 9920 datë 19.05.2008“Për Proçedurat Tatimore në Rep.e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr 8438 datë 28.12.1998 “ Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.
- Ligji nr 7703 datë 11.05.1993 “Per sigurimet shoq. shëndet. në Rep e Shqipe.” i ndryshuar
- Ligji nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

- Ligji nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar.
- Ligji nr 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike” i ndryshuar.
- Ligji Nr 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.
- Ligji Nr 183/2014 “Per Inspektoratin Kombetare te Mbrojtjes territorit”
- Ligji Nr 7697 datë 07.04.1993“Për kundravajtjet Administrative” i ndryshuar.
- Ligji Nr 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar”
- Ligji Nr 8503, datë 30.6.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumente Zyrtare”
- Ligji Nr 7501 datë 19.07.1991 “Për Tokën”
- Ligji Nr 9948 datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujëve të Pronësisë mbi tokën Bujqësore”
- Ligji nr 10465 datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në RSH”
- Ligji nr 8518 datë 30.07.1999 “Për Ujitien dhe Kullimin”, i ndryshuar
- Ligji nr 9533 datë 15.05.2006 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” të ndryshuar
- Ligji nr 9942 date 26.06.2006 “Per mbrojtjen nga zjarri” i ndryshuar

Si dhe në gjithë legjislacionin në fuqi sipas fushave përkatse të kompetencave të pushtetit lokal.

III. Organizimi

- Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri objektive dhe të ofrojë këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e bashkisë. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Misioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të mbështesë menaxhimin e bashkisë për kryerjen e përgjegjësive, mision i cili realizohet duke:

1. Mbështetur menaxhimin për arritjen e objektivave

2. Kryer vlerësime të pavarura të sistemeve të kontrollit dhe efencës, bazuar në standartet profesionale të miratuara.

3. Ruajtur një ambjent bashkëpunues i cili të nxisë nivelin profesional të audituesve.

Auditimi ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar.

Vlerat që karakterizojnë veprimtarinë e auditimit të brendshëm janë:

- **Integriteti**, pra nga ndërhmeria, objektiviteti, aftësia, shmangia e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë audituese.
- **Pavarësia dhe objektiviteti**, pra nga pavarësia në ushtrimin e veprimtarisë audituese dhe dhënien e opinioneve e gjykimeve objective gjatë kryerjes së auditimeve.
- **Ngritja e vazhdueshme profesionale**, pra angazhim dhe përpjekje të vazhdueshme për formimin dhe zhvillimin profesional, ngritje dhe përmirësim të njohurive.
- **Profesionalizmi**, pra zbatim i standarteve me kujdesin e duhur profesional dhe korrektësi, mbështetur në praktikat me të mira.
- **Komunikimi dhe informimi**, pra komunikim korrekt, objektiv, të qartë, konciz dhe konstruktiv në veprimtarinë audituese.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm e fokusuar në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, rrenaxhimit të riskut dhe jep siguri të arsyeshme nëse:

- informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- asetet janë ruajtur;
- veprimtaria e subjekteve është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara; dhe,
- objektivat kryesore të përcaktuara në programet dhe planet e subjekteve që auditohen do të arrihen.

- **Organizimi, përbërja dhe funksionimi i NJAB.**

Struktura e auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e strukturës së bashkisë është miratuar me vendim të këshillit bashkiak me përbërje 3 (tre) punonjës 1 (një) Shef Sektori dhe 2 (dy) specialist auditimi.

Në mbështetje të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, varësia direkte e njësisë së auditimit është nga titullari i institucionit (Kryetari i Bashkisë).

IV. Rezultatet e veprimtarisë së AB

- **Analiza e programeve të auditimit të brendshëm 2022.**

Për vitin 2022 me shkresën nr. 2687 prot. datë 18.10.2022, është miratuar plani vjetor i auditimit për vitin 2023, ku janë programuar për auditim drejtoritë, sektorët e varësisë.

Gjatë vitit 2022. Sektori i Auditit të Brendshëm ka kryer 5 misione auditimi kundrejt 6 misione të programuara ose 83 % e planit vjetor .

Bazuar në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" , Neni 12 , Pika "ç". Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër të M.F nr.100, datë 25. 10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar, Shkresën me nr. 5725 datë 02.06.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH "Për garantimin dhe funksionimin e shërbimit zjarrfikës dhe zbatimin e akteve nënligjore që normojnë veprimtarinë e MZSh-së në bashki", për të siguruar që veprimtaria e auditimit të brendshëm të jetë shërbim i dobishëm për menaxhimin e Bashkisë; në muajin Qershor 2022 i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë dhe kemi miratuar ndryshimet në Planin Vjetor të auditimit për vitin 2022, me shkresën nr.1654 datë 29.06.2022.

Sektori i Auditit të Brendshëm ka kryer 5 misione auditimi kundrejt 6 misione të programuara ose 83 % e planit vjetor

Sektorët që duheshin audituar sipas Planit vjetor të ndryshuar si më poshtë :

- Sektori i Policisë Bashkiake
- Sektori i Turizmit, Kulturës, Arësimit, Sporteve dhe Rinisë

- Sektori i Emergjencave Civile
- Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
- Sektori i Rugeve Rurale
- Sektori i të Ardhurave dhe Pronës Publike

Auditime të përfunduara gjatë vitit 2022 :

- Sektori i Policisë Bashkiake
- Sektori i Turizmit, Kulturës, Arësimit, Sporteve dhe Rinisë
- Sektori i Emergjencave Civile
- Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
- Sektori i Rugeve Rurale

Sektori i Auditit të Brendshëm ka kryer 5 misione auditimi kundrejt 6 misione të programuara ose 83 % e planit vjetor

Nga plani vjetor i miratuar mbetet pa u realizuar auditimi në Sektorin e të Ardhurave dhe Pronës Publike, auditim të cilin kemi planifikuar ta kryejmë gjatë vitit 2023.

- **Analiza e misioneve të AB**

Nga totali i auditimeve të realizuara, 80 % e tyre kanë qenë të programuara në programin vjetor 2022.

Gjatë vitit 2022 janë ushtruar auditime të jashtme:

- nga Drejtoria Rajonale Ndhmës Ekonomike Dibër për ndihmën ekonomike dhe
- nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

Për të dy kontrollet e ushtruara kemi qenë në kontakt direkt me grupet e kontrollit për problematikat e konstatuara dhe ndjekjen e tyre.

- Fushat me rrisht me të lartë dhe trajtimi i tyre

Në planet Strategjike dhe Vjetore janë identifikuat dhe vlerësuar rrishtet kryesore për veprimtarinë e bashkisë.

Për vlerësimin e rrishteve është vepruar në bazë të metodologjisë të percaktuar në ligjin për auditimin e brendshëm dhe manualin e procedurave të auditimit.

Në bazë të rrishteve të vlerësuar janë hartuar edhe programet e auditimit duke parashikuat shtrirje kohore të ndryshme, për fusha me rrisht të ndryshëm.

Faktoret e marrë parasyshe në vlerësimin e rrishtit kanë qenë:

- Vlera dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të subjektit të audituar;
- Zbatimi i ligjshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme nga subjekti;
- Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve, pronë e subjektit publik;
- Kërkesat e raportimit financiar;
- Mjedisi i kontrollit në subjekte;

- Gjetjet kryesore dhe vlerësimet e sistemeve

Në ushtrimin e funksionit Sektori i Auditimit të Brendshëm është bazuar në parimet dhe standartet e auditimit, duke vlerësuar subjektet e audituara në përdorimin e fondeve me dobi, kursim dhe frytshmëri.

Të dhënat tregojnë për ecurinë pozitive dhe performancën të mirë të drejtorive dhe sektorëve në varësi të bashkisë.

Në bazë të pozicioneve të punës, ndarjeve të funksioneve, në ballafaqim me detyrat e parcaktuara në rregullore, urdhërave administrativ të lëshuar nga titullari si dhe në njohjen dhe zbatimin e akteve ligjore, funksionojnë për një kontroll të brendshëm sa më efikas për të zvogëluar riskun e humbjeve dhe arritjen e objektivave. Për forcimin e masave të Kontrollit në fund të çdo jave personeli njihet me aktet ligjore dhe nënligjore, azhornimin e tyre duke i studiuat dhe diskutuar.

Zhvillohen takime për diskutimin e problematikave të caktuara, mbledhje të zakonshme, analiza mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore.

Institucioni ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e dispozitave ligjore që ndryshojnë. Informacionet kontabile dhe financiare janë të sakta dhe të qëndrueshme sepse veprimet kryhen me transaksione bankare dhe aty gjendet një sistem i lartë sigurie dhe qëndrueshmërie për çdo levizje dhe veprim.

Tematikat e auditimit janë mbështetur kryesisht në metoda auditimi me kosto efektive, që ul riskun e auditimit në një nivel të pranueshëm, duke u bazuar në informacionet lidhur me organizimin e subjektit që janë audituar.

Bazuar në konstatimet nga SAB janë lenë për zbatim rekomandimet, ku përmes dërgimit të rekomandimit në subjektet e audituara, SAB realizon funksionin këshillues, si dhe ndihmon për të rritur përgjegjshmërinë e punonjësve, pranimin e përgjegjësive dhe marrjen e masave korigjuese që ndikojnë në përmirësimin e punës për të ardhmen, gjithmonë duke respektuar pavarësinë.

Për subjektet që janë audituar është ndjekur procedura:

- Njoftimi paraprak për auditim, duke përcaktuar periudhen që do të kryhet auditimi.
- Hartimi i programit të punës, miratuar nga drejtuesi i auditit.
- Në përfundim të procesit të auditimit, grupi i auditimit ka përpiluar projekt raportin e auditimit ku në takimin pajtues janë ballafaquar faktet e konstatuara, pas sqarimit të problematikave
- Hartimi i raportit final dhe në mënyrë të përmbledhur është njoftuar Titullari.

- *Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.*

Gjatë vitit 2022 objektivat janë përmbushur në të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

1. Vendosja e objektivave.

Nga natyra e saj njësia zbaton disa strategji sektoriale siç është, strategjia për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikqyrjen e tregut, strategjia për zhvillimin e biznesit, strategjia kombëtare për pronësinë intelektuale. Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësit civil", Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me ndryshime, Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", Ligjin Nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare", Ligjin Nr.8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me ndryshime; Ligji Nr. 114, datë 22.10.2015 "Për Planifikimin e Territorit", i azhurnuar, Ligjit Nr.7674, datë 23.2.1993 "Për shërbimin dhe inspektoriatin veteriner", i azhurnuar, Ligjit Nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile"; Ligjit Nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", VKM Nr.511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore", VKM Nr.390, datë 06.08.1993 "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare, me VKB nr. 27 date 23.02.2016 është miratuar rregullorja "Mbi Organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Klos dhe Njësive Administrative". Në rregullore janë përcaktuar objektivat e përgjigjthshme, organizimi i punës struktura dhe funksionet përkatëse. Për vitin 2022, njësia në bazë të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ka hartuar projektbuxhetin dhe ka marrë në konsideratë dhe risqet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave. Lidhur me buxhetin e caktuar çdo menaxher dhe strukturë varësie merr informacion krahas takimeve të ndryshme dhe me shkresë zyrtare.

2. Etika personale dhe profesionale.

Nëpunësit e SAB duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", rregulla të cila janë të përcaktuara në rregulloren e

brendshme të Bashkisë dhe gjithashtu është përcaktuar procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

3. Struktura organizative.

Institucioni ka funksionuar në bazën e strukturës organike të miratuar me Vendimin Keshillit Bashkiak nr. 7 date 15.2.2022 "Per miratimin e detajimit te buxhetit per vitin 2022" ku percaktohen miratimi i pagave dhe numrit te punonjesve respektivisht pika 5 dhe 14 te ketij vendimi ku numri i punonjesve te aparatit te bashkise eshte percaktuar 150, bordi i ujitjes dhe kullimit 2, MKZ 12, personeli mesimor dhe jo mesimor arsimit parashkollor 45, personeli ndihmes parauniversitar 5. Me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Klos nr. 42, datë 04.01.2021, eshte miratuar struktura, organika dhe numri i punonjesve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së bashkisë.

Është e mirë përcaktuar ndarja e punës dhe e përgjegjësiave. Struktura mbulon të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë dhe bën të mundur qarkullimin e informacionit. Koordinimi dhe bashkëpunimi i drejtorive bëjnë që të jetë strukturë e decentralizuar duke respektuar shkallën hierarkike.

Secili sektor, drejtori ka të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe të nëpunësve në përberje të tyre. të mirëpërcaktuara në përshkrimet e punës, sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin e KM nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruara" dhe Udhëzim nr.2, datë 07.04.2014 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

4. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e SAB i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe Kodit të Punës. Në bazë ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, ligjit për statusin e nëpunësit civil, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj., Titullari i njësisë, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se, punonjësit mbikëqyren në kryrjen e detyrave të tyre nga, drejtuesit dhe ajo është e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

5. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, njësia ka miratuar përshkrimin e punës për çdo pozicion pune në institucion ku përfshihen detyrat që duhen kryer nga çdo strukturë dhe për çdo vit është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Trajnimet janë kryer në bashkëpunim me Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike.

Aktivitetet e kontrollit. Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synin arritjen e objektivave dhe të misionit të saj. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë..

Në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenin 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III "Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit", pika 3.2 "Cikli i MFK-se", Hapi 5 "Gjurmët e auditimit", njësia ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj. Për regjistrimin dhe sigurimin e të dhënave kontabël nga Drejtoria e Financës për përpunimin e të dhënave përdoret programi "Excel" ndërsa Sektori i Taksave ka sistem tjetër përpunimi të dhënash dhe ruajtjen e tyre.

Informim komunikimi. Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për të ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave. Menaxherët e njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin ka funksionuar në njësi dhe në strukturat vartëse. Titullari dhe nëpunësi autorizues informohen nga drejtuesit e programeve

me anë të mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Drejtoria e Financës, raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, raporteve të monitorimit çdo 3-muaj. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtëpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme.. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

Monitorimi. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullari informohet vazhdimisht nga drejtorët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve, informacioneve apo, raporteve të ndryshme. Drejtuesit nën mbikëqyerjen e Titullarit, raportojnë realizimin e çdo objektivi në përgjegjësinë e gjithsecilit. Krahas arritjeve analizohen dhe shkaqet e mosrealizimeve. Bashkia në përbërje të strukturës ka dhe Sektorin e Auditimit të Brendshëm i cili është miratuar në Strukturën e Bashkisë që në vitin 2020, dhe ka funksionon sipas ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, garanton objektivitetin dhe pavarësinë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Klos. Në bazë të ligjit Sektori i Auditimit të Brendshëm varet dhe raporton direkt tek titullari i njësisë.

Procesi i monitorimit më shumë konsiston në realizimin e menaxhimit financiar. Sektorin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, ka kryer auditime mbi bazë sistemi, kryesisht për sistemin e proceseve organizative, si dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të njësisë dhe sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sipas kërkesave të ligjit dhe manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Si konkluzion, nga më lart rezulton se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në sistemin e Bashkisë Klos ka funksionuar mirë, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin është kuptuar dhe ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë dhe në strukturat vartëse, punonjësit kanë njohuri mbi ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për pasojë, drejtuesit kanë bërë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Njësia e auditimit ka patur një rol të vecantë për identifikimin dhe zbatimin e MFK dhe informimin periodik të titullarit.

V. Rekomandimet e Auditimit.

Për gjetjet e konstatuara nga ana jonë, është përcaktuar përgjegjësia, fakt ky që konsiderohet si tregues pozitiv i performancës së auditimit të brendshëm dhe tregon se rezultatet e punës janë shtrirë përtej konstatimit të gjetjeve.

Kështu përcaktimi i përgjegjësive nga auditimet e realizuara vitet e mëparshme ka sjellë efekt pozitiv, duke patur impakt në veprimtarinë e subjekteve të audituara.

Kështu për vitin janë dhënë rekomandime për masa organizative .

Një ndër përgjegjësitë e auditimit ka qenë ndjekja e zbatimit të rekomandimeve ku për çdo program auditimi, në drejtimet e auditimit ka qenë edhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Vlerësimi i veprimtarisë së subjekteve ka konsideruar si tregues të rëndësishëm shkallën e zbatimit të rekomandimeve, ku ka rezultuar se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve.

VI. Analiza e kapaciteteve audituese

- Problemet e konstatuara në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e njësisë.

Njësia e auditimit të brendshëm pranë Bashkisë Klos është ngritur në përputhje me VKM nr. 83 date 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", ku cilësohet: "*Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi, tre auditues, përfshirë drejtuesin e njësisë*".

- Kapacitetet audituese

Spektori i Auditimit të Brendshëm është miratuar me vendim të Titullarit me përbërje 3 (tre) punonjës 1 (një) Shef Spektori dhe 2 (dy) specialist auditimi.

Punonjësit kanë përfunduar çertifikimin pra kanë fituar titullin auditues i brendshëm në sektorin publik.

- **Zvillimi i aftësive profesionale**

Gjatë vitit 2022 nga punonjësit është ndjekur trajnimi i vijueshëm i detyrueshëm organizuar nga NJQH për auditimin e brendshëm.

- **Te tjera**

- Është hartuar karta e auditimit të brendshëm ku sipas standarteve të auditimit (standarti 1010), formalizon dhe pozicionon veprimtarinë e njësisë të auditimit të brendshëm të institucionit Bashkia Klos dhe specifikon qëllimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

- Është përditësuar rregullisht dosja e përhershme e auditimi pas plotësimit të çdo angazhim auditimi.

- Është hartuar, miratuar dhe dërguar pranë Ministrisë Financave, programi strategjik 2023 – 2025, i auditimit si dhe programi vjetor i auditimit për vitin 2023.

- Eshte hartuar Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe performances së auditimit të brendshëm i cili përcakton nëse procedurat janë zbatuar në përputhje me standartet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, karten, rregulloren e brendshme, kodin e etikës dhe aktet ligjore e nënligjore ne fuqi per fushen e auditimit të brendshëm.

Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë perbehet nga tre komponente:

- Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë;
- Vetëvlerësimi periodik;
- Reagimet e subjektit të audituar;

Është hartuar rregullorja per hetimin administrative të ninjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashki në perputhje me ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit”.

Janë hartuar regjistri i sinjalizimit të brendshëm dhe regjistri i kërkesës për

mbrojtje nga hakmarrja si detrim ligjor i njësisë auditimit në përputhje me ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit".

VI. Konkluzione

- Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme.

- Prioritetet për vitin e ardhshëm

Për vitin 2023 Sektori i Auditimit të Brendshëm do të arrijë objektivat si:

Shtimi i vlerës përmes:

- Mbrojtjes së vlerës së subjekteve duke përsosur mjedisin e kontrollit të brendshëm
- Garantimi i zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me praktikat më të mira profesionale.
- Menaxhimi efektiv i burimeve të auditimit, bazuar në aftësitë profesionale si dhe përmes koordinimit me auditimin e jashtëm.
- Reduktivitetin e kostove të auditimit pa cënuar mbulimin e fushave me risqe më të larta.
- Bashkëpunimi cilësor e profesional me subjektet e audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
- Konsolidimi dhe rritja e auditimeve të performancës.
- Rritja e cilësisë së raportimit duke respektuar standartet në fushën e raportimit

Ndryshimi i imazhit të këtij shërbimi do të jetë synimi kryesor, duke informuar publikun dhe aktore specifike, për të përcjellë perceptimin se ky shërbim profesional dhe i pavarur, së pari është në shërbim të mbrojtjes së interesave të tyre.

Shefi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm

